



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Ref: 1902/192/BA/ah**  
**Nr. 01/2019**

**Bordi për Ankesa**, i përbërë nga Avdyl Hyseni, kryetar dhe Musa Dragusha e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën Nr. 1901/095/BA/ah të datës 25.01.2019 të parashtruesit “Radio Televizioni i Kosovës RTK1” përfaqësuar nga Liridon Dalipi, të paraqitur ndaj Vendimit Ref: 1812/1398/KPM/mf, të datës 27.12.2018 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datë 12.02.2019 mori këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pa bazuar Ankesa Nr. 1901/095/BA/ah e datës 25.01.2019 e parashtruesit “Radio Televizionit të Kosovës RTK1”, dhe mbetet në fuqi Vendimit Ref: 1812/1398/KPM/mf, i datës 27.12.2018 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

### **A r s y e t i m**

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Nr. Ref: 1812/1398/KPM/mf, të datës 27.12.2018, e ka obliguar RTK1 që në afat prej shtatë (7) ditësh përmes transmetimit t’i kërkojë falje Palës ankuese për transmetimin e të dhënave personale rreth gjendjes së tij shëndetësore, ashtu siç përcaktohet me nenin 30 paragrafi 1.2 te Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe sanksionon me gjobë në vlerë prej pesë mijë (5,000) euro, në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 te Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, për shkeljet e nenit 7 paragrafi 1.5 të Kodit të Etikës per Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM-2016/03.

Kundër këtij vendimi në afatin e paraparë ligjor Radio Televizioni i Kosovës RTK1 me datë 25.01.2019 ka parashtruar ankesë pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, procedurave për vënien e sanksioneve dhe sanksionit të shqiptuar me propozim që Bordi per Ankesa të aprovojë ankesën si të bazuar në tërësi dhe të anulojë vendimin e kundërshtuar.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datë 12.02.2019 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “Radio Televizionit të Kosovës”, si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Ref: 1812/1398/KPM/mf, të datës 27.12.2018 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara, sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike, duke u bazuar në dispozitat materiale përkatësisht në nenin 7 paragrafi 1 dhe 5 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, si dhe dispozitat procedurale që rregullojnë fushën e KPM-së.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 i Rregullores Nr. BA 2017/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:  
-Palëve dhe  
-Arkivit të KPM-së.

Avdyl Hyseni  
Kryetar i Bordit për Ankesa

